



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 134, Datë 11.04.2023

MBI

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN MARS 2023 PËR KLIENTËT
E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 KV**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar; dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.04.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1195 prot., datë 07.04.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Mars 2023 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

Konstatoi se:

- Me shkresën nr. 2343 prot., datë 03.04.2023, protokolluar me tonën me nr. 1195 prot., datë 05.04.2023, shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., ka depozituar në ERE kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin Mars 2023, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.
- Referuar kërkesës së sipërcituar të FSHU sh.a. evidentohet se shoqëria vijon të përfshijë koston e disbalancave në përlllogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësosë së Fundit, ndërkohë që ERE në mënyrë të përsëritur, me shkresën nr. 2030/1 prot., datë 14.12.2022, ka sqaruar FSHU sh.a. se:
...Në kuptim të nenit 6, pika 3 dhe pika 5, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” miratuar me vendimin nr. 201 të bordit të ERE-s, datë 04.12.2017, e ndryshuar, tarifa që FMF do të aplikojë/ngarkojë tek klientët, do të përfshijë kostot për blerjen e energjisë elektrike për këta klientë për periudhën e lëvrimit, mbi të cilën do të aplikohet dhe një marzh i furnizimit, i cili vendoset nga

Rregullatori. Sikurse përcaktuar në metodologji, kostot e imbalancave (zë i emërtuar nga shoqëria si disbalanca) do të llogariten dhe faturohen në përputhje me përcaktimet e Rregullave të Tregut dhe akteve të tjera në fuqi.” duke kërkuar ndaj shoqërisë që të marrë në konsideratë vetëm komponentët e njohur dhe të përfshirë në formulën e përcaktuar në metodologji.

- Mbështetur në nenin 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Mars 2023 janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar.
 - Në zbatim të vendimit nr. 325, datë 14.12.2022 të bordit të ERE-s, kostot administrative të përlllogaritura për aktivitetin e furnizimit vijnë në mbeten në vlerën 1.06 lekë/kWh.
 - Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 Maj 2022 – 31 Dhjetor 2024, e miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 72, datë 13.04.2022, është 0.85 lekë/kWh.
 - Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV, në zbatim të vendimit të bordit të ERE nr. 324, datë 14.12.2022, vijon të jetë 1.55 lekë/kWh.
- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, e ndryshuar, referuar aplikimit të FSHU sh.a. si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Mars 2023, përlllogaritet si më poshtë:

<i>Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin mars 2023</i>		
	Njësia	Çmimi
CBEt	ruar i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh 16.53
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh 0.50
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh 1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh 0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh 1.55
Çmimi i energjisë = CBEt +Pr* CBEt+ TRr+TSHt+CA		Leke/kWh 20.49

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë *20.49 Lekë/kWh për muajin Mars 2023*.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit sh.a., për muajin Mars 2023, prej 20.49 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI